

KËRKESË
Nr. 134/1, datë 19.1.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 147, datë 13.3.2023, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti ‘Ndërtimi i linjës 110 kV Unaza e Tiranës’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “arë” dhe “ullishte”, bazuar në pikën 4, të nenit 17 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar; marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligjin nr. 88/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011 për projektin ‘Eficiencia Energjetike – Programi për Sektorin e Transmetimit të Energjisë Elektrike’”; ligjit nr. 84/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfV Frankfurt Am Main, në lidhje me Marrëveshjen e Huas, datë 30.6.2015”, në shumën 40 milionë euro, ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) dhe KfV, në mbështetje të projektit “Eficiencia Energjetike – Programi për Sektorin e Transmetimit të Energjisë në Sektorin e Transmetimit ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë – Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës”, në bazë të të cilave është hartuar Raporti i Vlerësimit i miratuar, bazuar në Planin e Marrjes së Tokës dhe Kompensimit LACP (RAP), sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 818,315.92 (tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e dy) lekë.

Pasuritë me nr. rendor 7–21 hiqen nga lista e shpronësimit të VKM-së nr. 147, datë 13.3.2023, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i linjës 110 kV Unaza e Tiranës”, dhe kthehen në gjendjen e tyre fillestare, për sa kërkuar nga subjekti kërkuar OST, me shkresën nr. 3853 prot., datë 15.7.2025, protokolluar në ASHSH me nr. 819 prot., datë 16.7.2025.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I LINJËS 110 kV UNAZA E TIRANËS”

0	Nr. shtylle	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE					VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				Shënime
										ARË			VLERA TOTALE (lekë)	
		Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)		
		A	B	C	C	Ç	D	E	F	L	M	N	Y	
1	1	Zurije Lorenc Klodian	Ferit Myrteza Myrteza	Gjashta Gjashta Gjashta	Petrelë	2947	371/11	Arë	8,000	162.05	1,406	227,842	227,842	Sek. E: Të mos kryhen veprime, AMTP e parregullt
2	1	Zurije Lorenc Klodian	Ferit Myrteza Myrteza	Gjashta Gjashta Gjashta	Petrelë	2947	371/11	Arë	8,000	139.90	1,406	196,699	196,699	Sek. E: Të mos kryhen veprime, AMTP e parregullt
3	8	Skender	Abdyl	Tujani	Mjull, Bathore	2704	381/154	Ullishtë	4,675	254.08	602	152,956	152,956	
4	9	AUTO ZIP			Mjull, Bathore	2704	381/173	Ullishtë	16,000	190.44	602	114,645	114,645	
5	10	CITYMEAD			Mjull, Bathore	2704	509/7	Ullishtë	3,500	94.67	602	56,991	56,991	Sek. E: Regjistrohet kërkesëpadi, Gjykata e Shkallës Parë nr. 3479, datë 23.5.2023
6	11	Suela Mimoza	Zyhdi Jahja	Husha Husha	Mjull, Bathore	2704	508/2	Ullishtë	4,000	114.92	602	69,182	69,182	
VLERA TOTALE													818,315.92	